KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Kuvendi Komunal-Junik
Nr. 03-01/26
Datë: 09.07.2026, ora 14^{00}

PROCESVERBAL

Mbledhja e tretë e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më datën 9 Korrik 2026, në orën 14^{00} , Objekti i Kuvendit Komunal Junik (Salla e takimeve).

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Këshilli si në vijim:

1. Besart Tofaj - Nënkryetar i Komunës - Koordinator i KKSB-së,
2. Skender Kasumi – zv.Komandant i Stacionit Policor në Junik,
3. Driton Syla - "Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei- Haletije Xhaferi", Junik,
4. Liberta Hoxha - Zyrtare për Barazi Gjinore,
5. Xhavit Velijaj - Drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport,
6. Florant Pepshi - Kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut,
7. Blerina Sallaj - Përfaqësuese e Këshillit Lokal për Siguri Publike,
8. Shkëlzen Shehu - Përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale,
9. Zeqë Shehu - Përfaqësues nga OJQ,
10. Leonita Jasiqi - Përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim,
11. Haki Jasiqi - Përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit.

Në këtë mbledhje mori pjesë edhe z. Tafë Gaxherri – Menaxher i KRU "Hidrodrini" në Junik.

Në këtë mbledhje munguan; Imer Krasniqi - Përfaqësues i Bashkësisë Islame, Floris Miroci - kryesuese e Komitetit për Komunitete, Guxim Gjocaj - Përfaqësues nga Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, Alban Miroci - përfaqësues i mediave lokale dhe Qamil Jasiqi - Përfaqësues nga Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara.

Mbledhjen e Tretë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2026 e shpalli të hapur koordinatori i KKSB-së z. Besart Tofaj, i cili përshëndeti pjesëmarrësit në këtë takim, dhe nga anëtarët e Këshillit kërkoj miratimin e Rendit të Ditës si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
3. Mirëmbajtja e shkollave siguria në dhe për rreth objekteve shkollore,
4. Zjarret fushore dhe malore, pengesat për qasje të zjarrfikësve,
5. Informatë nga KRU "Hidrodrini" lidhur me shërbimet e ujësjellësit,
6. Të ndryshme.

Ky rend i ditës u miratua me 11 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Pika e Parë të Rendit të Ditës
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Koordinatori, njëherësh Nënkryetari z. Besart Tofaj, tha se materialet i keni pranuar me kohë dhe se, nëse keni vërejtje apo komente rreth procesverbalit, mund t'i bëni.

Kjo pikë e rendit të ditës u miratua me 11 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Pika e Dytë e Rendit të Ditës
Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut

Rreshteri Skender Kasumi tha se gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut vijon të mbetet e qetë, dhe se Policia e Kosovës po e kryen punën sipas kompetencave që ka. Nga mbledhja e kaluar e KKSB-së janë evidentuar 3 raste penale, ku janë konfiskuar 2 armë dhe një sasi municioni, si dhe ka pasur të arrestuar lidhur me këto raste. Në trafik, gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë aksident, por janë shqiptuar 60 gjoba, kryesisht për tejkalim të shpejtësisë dhe parkime të parregullta. Për sezonën verore 2026 është hartuar plani operativ dhe janë paraparë projekte për parandalimin e zjarreve.

Blerina Sallaj tha se janë në bashkëpunim me një organizatë që po zhvillon një projekt, ideja e të cilit është hartimi i një strategjie kombëtare për shëndetin mendor. Ajo vlerësoi se kjo temë lidhet me aspektin e sigurisë. Nga grupi joformal ka dalë propozimi që të krijohet një faqe në Facebook ku qytetarët mund të kontaktojnë sipas nevojave për ndihmë. Si temë u ngrit edhe ekspozimi i të dhënave personale, ku sipas praktikave të komunave tjera, grupi njofton nëse në ndonjë portal dalin lajme që mund të përmbajnë të dhëna personale. Ajo shtoi se tashmë i janë drejtuar kryetarit të komunës me një kërkesë për funksionalizimin e një qendre për komunitetin, specifikisht për moshat e vjetra, ku ata do të kenë mundësi të kalojnë një pjesë të kohës.

Haki Jasiqi pyeti nëse ka raste kur një person kapet me armë, a lirohet në procedurë të rregullt apo jo.

Rreshteri Skender Kasumi tha se kjo varet nga prokuroria, pasi policia ofron faktet dhe raportet e veta, ndërsa vendimin e merr prokuroria.

Pika e Tretë e Rendit të Ditës
Mirëmbajtja e shkollave siguria në dhe për rreth objekteve shkollore

Xhavit Velijaj tha se gjendja e shkollave në Komunën e Junikut është shumë e mirë. Përveç investimeve që po bëhen në kuadër të një projekti për efiçiencë të energjisë, janë planifikuar edhe disa ndërhyrje në mirëmbajtje. Sa i përket sigurisë, nuk është evidentuar ndonjë problem, pasi nxënësit tashmë janë në pushim. Ai falënderoi Policinë e Kosovës, stacionin në Junik, për praninë e përditshme në hyrje të shkollës dhe patrullat rreth objekteve shkollore. Ai shtoi se kamerat e sigurisë janë vendosur dhe projekti është përmbyllur, duke mundësuar mbikëqyrjen e të gjithë hapësirës rreth shkollave.

Rreshteri Skender Kasumi tha se, përveç kamerave të shkollave, policia monitoron me kujdes edhe kamerat e qytetit që mbulojnë objektet shkollore dhe hyrje-daljet e tyre.

Haki Jasiqi pyeti se kujt i takon përgjegjësia për rregullimin e kronit të ujit në oborrin e shkollës fillore. Xhavit Velijaj tha se kjo çështje është diskutuar dhe adresuar për t'u rregulluar. Zeqë Shehu shtoi se kroni është rregulluar disa herë, por dyshohet se po dëmtohet qëllimisht.

Haki Jasiqi pyeti se kush duhet ta mirëmbajë kronin e ujit te lapidari në qendër të Junikut, duke theksuar se shërbimet publike nuk po punojnë mirë, pasi për një pjesë të vogël të kronit ka shumë humbje të ujit.

Florant Pepshi tha se kanë pasur takim me këshillin drejtues të shkollës dhe me drejtorin e shkollës fillore, ku si shqetësim është ngritur mosrregullimi i hyrjes së shkollës. Ai shtoi se ka parë një projekt nga drejtori i DKARS, por u shpreh skeptik për realizimin e tij me atë kosto.

Xhavit Velijaj tha se hyrja e shkollës është shqetësuese, pasi aty ndodhet edhe një udhëkryq. Ai ka kërkuar nga drejtori i shkollës që të kufizohet dalja e nxënësve, pasi tashmë ka hapësirë të mjaftueshme që ata të qëndrojnë brenda objektit. Ai kërkoi nga këshilli i shkollës që të ushtrohet presion për të mos lejuar daljen e fëmijëve jashtë hapësirës së shkollës, pasi përgjegjësia bie drejtpërdrejt mbi menaxhmentin e shkollës. Ai shtoi se vitin e kaluar kjo masë ka funksionuar shumë mirë.

Leonita Jasiqi tha se infrastruktura shkollore është e mirë, por kërkoi që shkolla të respektojë rregullat në mënyrë strikte. Ajo përmendi praktikat e komunave përreth, ku klasat I–V kanë kufizime të caktuara, dhe sugjeroi që të merren praktikat më të mira. Ajo shtoi se, për shkak të ushqimit, fëmijët nuk kanë më nevojë të dalin jashtë perimetrit të shkollës, pasi tashmë lejohet që ushqimet të merren me vete.

Zeqë Shehu tha se sa i përket daljes së fëmijëve, faji bie tek prindërit që nuk u sigurojnë ushqimet e nevojshme, si dhe tek mungesa e disiplinës së nxënësve.

Nënkryetari Besart Tofaj tha se, derisa një prind e dërgon fëmijën në shkollë, përgjegjësia bie mbi menaxhmentin e shkollës dhe jo mbi prindërit.

Shkëlzen Shehu pyeti drejtorin e DKARS-it nëse është bërë kërkesë për shkallë emergjente në objektin e ri shkollor.

Xhavit Velijaj tha se ka biseduar me një zyrtar në Ministri, por ende pa ndonjë rezultat, dhe se jemi duke pritur të shihet se çfarë do të ndërmarrë Ministria.

Nënkryetari Besart Tofaj tha se diskutuar dhe insistuar në Ministri që edhe shkolla "Edmond Hoxha" të përfshihet në projektin e Ministrisë për ndërtimin e shkallëve emergjente, pasi në disa komuna ku ka qenë projekti ndërtimor i shkollës i njëjtë ka mungesë të shkallëve emergjente. Ai shtoi se Ministria e ka paraparë buxhetin për këtë projekt në vitin 2026 dhe se procedurat tashmë varen nga ta.

Pika e Katër e Rendit të Ditës
Zjarret fushore dhe malore, pengesat për qasje të zjarrfikësve

Shkëlzen Shehu tha se zjarret fushore janë ato që ndezin bimësinë, barin e thatë, kodrat dhe livadhet, të cilat qytetarët shpesh i nënvlerësojnë duke i konsideruar më të menaxhueshme, por që mund të shkaktojnë dëme të mëdha. Ai shtoi se zjarret mund të shkaktohen edhe nga rrufeja, por në Komunën e Junikut nuk është evidentuar ndonjë rast i tillë. Rastet më të shpeshta janë ato nga pakujdesia e qytetarëve gjatë piknikëve, kur zjarri mund të dalë jashtë kontrollit. Në këto raste është e domosdoshme që të lajmërohen zjarrfikësit sa më shpejt, pasi zjarri mund të përhapet në malet përreth.

Ai theksoi se shpeshherë në zonat malore zjarrfikësit detyrohen të intervenojnë me çanta shpine, pasi nuk mund të afrohen me kamion për shkak të mungesës së rrugëve të hapura. Zjarret shpesh shkaktohen edhe nga djegia e mbeturinave, të cilat depërtojnë në mal dhe mund të zgjasin 2–3 ditë pa u shuar. Shehu kërkoi që të ndalohet rreptësisht ndezja e zjarreve në piknik, sidomos në zonën e bjeshkëve, për shkak të temperaturave të larta.
Ai informoi se janë mbajtur takime me Policinë e Kosovës për vetëdijesimin e qytetarëve rreth zjarreve fushore dhe malore, duke theksuar se shkaktimi i zjarrit është vepër penale. Aktualisht, zjarrfikësit e Junikut kanë dy kamionë dhe kanë pranuar donacione me pajisje nga KFOR-i italian. Kohë pas kohe përdoret edhe droni për të vëzhguar zonën e Junikut.

Zeqë Shehu pyeti se si trajtohet si vepër penale: ai që lajmëron apo ai që e ka shkaktuar zjarrin. Rreshteri Skender Kasumi sqaroi se pa u identifikuar shkaktari nuk mund të ketë përgjegjësi, por në momentin që dihet, merren masat përkatëse, varësisht edhe nga pasojat e veprimit.

Shkëlzen Shehu shtoi se në Komunën e Junikut ka raste kur janë dënuar persona për shkaktim zjarri, pasi një rast kishte dëmtuar edhe trafon e rrymës, duke lënë një lagje pa energji elektrike. Ky veprim është cilësuar si shkaktim i rrezikut të përgjithshëm.

Xhavit Velijaj pyeti nëse lejohen zjarret e kontrolluara. Shkëlzen Shehu tha se zjarret e kontrolluara mund të lejohen vetëm nëse njoftohet njësia e zjarrfikësve dhe ata qëndrojnë gjatë gjithë kohës, por duhet të kemi parasysh se kështu dëmtohet ekosistemi.

Blerina Sallaj pyeti nëse janë evidentuar zonat me rrezikshmëri më të lartë për zjarre, ku qasja është më e vështirë, si dhe nëse ka qasje me kamion në çdo lagje të Junikut. Shkëlzen Shehu u përgjigj se kjo është pjesë e planit të vlerësimit të rrezikut të komunës, i cili është në proces të rifreskimit. Në plan parashihet hapja e rrugëve malore ku nuk mund të arrihet me kamion zjarrfikës. Ai shtoi se ka qasje në çdo lagje të

Junikut dhe falënderoi KRU “Hidrodrini” për vendosjen e hidranteve në çdo lagje, si dhe në shkollën fillore dhe të mesme. Ai informoi se kamioni mund të mbushet me ujë nga Lumi Erenik.

Haki Jasiqi pyeti nëse ka vende të caktuara për mbushjen e kamionit dhe nëse duhen shënjuar për qasje më të lehtë.

Shkëlzen Shehu tha se kamioni mund të mbushet kudo në Lumin Erenik, pasi ka gypa, si dhe në bunare e pishina private, pasi kjo u lejohet zjarrfikësve në rast intervenimi. Ai shtoi se ekziston një hidrant që nuk ndalet asnjëherë, madje as kur ka reduktime të ujit.

Pika e Pestë e Rendit të Ditës
Informatë nga KRU “Hidrodrini” lidhur me shërbimet e ujësjellësit

Tafë Gaxherri tha se furnizimi me ujë është i kënaqshëm. Sa i përket shërbimeve, çdo konsumator është i obliguar të ketë kontratë, ku janë të sqaruara të drejtat e konsumatorit dhe të KRU “Hidrodrini”, si dhe shërbimet që ofrohen. Aktualisht, shpenzimi i ujit është shumë i lartë; një konsumator ka shpenzuar deri në 450 mijë litra ujë. Ai theksoi se nëse uji i pijes përdoret për ujitjen e oborreve dhe mbushjen e pishinave, rrezikohet furnizimi i përgjithshëm me ujë.
Sa i përket shpenzimit dhe faturimit, situata është problematike, pasi humbjet arrijnë në 60%. Nga këto, deri në 30% pranohen si humbje teknike në rrjet, prishje dhe të ngjashme, ndërsa 30% tjera janë lidhje ilegale, pra vjedhje. Ai kërkoi nga Policia e Kosovës që të angazhohet më shumë, në mënyrë që, nëse shohin ndonjë kompani apo punëtor duke ndërhyrë në shaktet apo valvulat e ujësjellësit, të identifikojnë nëse janë të autorizuar për ndërhyrje në rrjet apo përreth tij.

Leonita Jasiqi u shpreh se për herë të parë po dëgjon për kontratën që duhet ta kemi me Hidrodrinin, dhe se ky është një hap i mirë për të adresuar të drejtat mes konsumatorit dhe Hidrodrinit. Gjithashtu tha se ka ankesa që shumë familjeve që jetojnë në mërgim u shkojnë faturat sikur të kishin jetuar këtu, pra si bëhet matja e ujit të shpenzuar në këto raste.

Tafë Gaxherri tha se faturimi bëhet në bazë të leximit të ujëmatësit për secilin konsumator, nëse dera është e hapur dhe nëse ka qasje te ujëmatësi. Matja bëhet në baza mujore. Ne e kemi shkresën nga Zyra e Rregullatorit që të kursehet uji dhe të njëjtën e kemi shpërndarë tek Drejtoria e Shërbimeve Publike. Gjithashtu tha se në territorin e Komunës së Junikut janë 27 pika ku bëhet matja e ujit. Dhe se nëse dikush mendon që është faturuar më shumë se sa ka shpenzuar, atëherë mund të bëjë ankesë tek ne dhe ne e verifikojmë përsëri duke marrë faturën si dhe shënimet nga ujëmatësi.

Haki Jasiqi pyeti se a ka kufizim për anëtar apo për familje se sa ujë i lejohet të shpenzojë, dhe se a mund të merren masa ndaj tyre nga Hidrodrini. Tafë Gaxherri tha se Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit (ARRU) na i rregullon çmimet për secilin ofrues të shërbimit të ujësjellësit, dhe se ne nuk mund të marrim masa lidhur me sasinë e ujit që lejohet për shfrytëzim. Gjithashtu theksoi se në gjithë Junikun i kemi vetëm 5 familje që nuk kanë ujëmatës.

Tutje tha se kompania Hidrodrini furnizon, riparon dhe mirëmban rrjetin, ku çdo maksimumi 6 muaj testohet çdo valvulë. Tha se kompania e ka edhe inspektoratin për keqpërdorime dhe se edhe inspektorati komunal mund t'i ndalë abuzimet me ujë.

Nënkryetari Besart Tofaj tha se pikërisht sot është konsultuar me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe se inspektorët e komunës nuk e kanë asnjë kompetencë rreth asaj që ju e thatë, përveç se si qytetarë që kemi obligim që nëse shohim ndonjë keqpërdorim në secilën fushë ta raportojmë, por nuk e kanë obligim ligjor.

Tafë Gaxherri tha se këto i vendos komuna, sepse ARRU i ka lënë mundësinë ku është e lëshuar me shkrim se cilat janë veprat e jashtëligjshme, pastaj varet nga komuna nëse dëshiron t'i jetesojë apo jo. Tutje tha se për lidhje ilegale konsumatorët familjarë dënohen deri në 1000 euro, ndërsa bizneset deri në 3000 euro.

Blerina Sallaj pyeti se cilët hapa ka ndërmarrë kompania për të adresuar humbjet e ujit dhe a është adresuar që faturimi të bëhet sikur KEDS-i, ku nëse harxhon mbi një limit të caktuar atëherë paguan më shtrenjtë. Tafë Gaxherri u përgjigj se tarifat i rregullon ARRU dhe jo Hidrodrini, dhe se qytetarët tanë janë më të privilegjuarit sepse e kemi mbi 20 cent çdo metër kub më lirë se secila kompani KRU tjetër në Kosovë.

Haki Jasiqi pyeti se çka mund të bëjë Hidrodrini së bashku me komunën që të adresohen këto shqetësime dhe të mos mbesim pa ujë.

Tafë Gaxherri u përgjigj se gjendja është e mirë, dhe se 1700 konsumatorë marrin shërbim nga kompania. Nga 27 ujëmatësit që i kemi, është më e lehtë të identifikohen keqpërdoruesit.

Nënkryetari Besart Tofaj pyeti nëse mund të kërkohet nga inspektorati i kompanisë të bëjë kontrolle rutinë për identifikimin dhe ndëshkimin e atyre që bëjnë lidhje ilegale në ujësjellës.

Tafë Gaxherri u përgjigj se kjo është një veprimtari që zhvillohet vazhdimisht dhe shpesh është koordinuar edhe me Policinë për aksionet e tyre, por theksoi se duhet më shumë mbështetje nga Komuna përmes inspektoratit, sepse në komuna tjera inspektorati komunal dhe inspektorati i KRU-së i bëjnë së bashku inspektimet.

Nënkryetari Besart Tofaj tha se qëndron në atë që inspektorati komunal nuk ka asnjë kompetencë në këtë drejtim, por kërkoi nga menaxhmenti i KRU "Hidrodrini" që të drejtohet dhe të listojë cilat pika dhe aspekte mund të ndihmojë komuna, gjithmonë brenda kompetencave që i ka.

Pika e Gjashtë e Rendit të Ditës
Të ndryshme

Blerina Sallaj tha se ndoshta komuna duhet t'i paraqesë më shumë tek qytetarët që qyteti është i mbuluar me kamerat e sigurisë, sepse kjo do të ndikonte në mënyrë psikologjike që qytetarët të jenë më të përgjegjshëm, por edhe t'u rikujtohet se shfrytëzimi joracional i ujit të pijes është i ndaluar.

Zeqë Shehu pyeti Policinë se a janë të informuar dhe nëse ka ndërmarrë diçka lidhur me dëmtimin e një shtylle të ndriçimit ku janë të vendosura edhe kamerat e sigurisë për atë pjesë, dhe nëse ky veprim është i qëllimshëm. Rreshteri Skender Kasumi tha se janë të informuar dhe se Policia e Kosovës ka inicuar këtë rast.

Driton Syla e përsëriti kërkesën e tij për sinjalizimin te Teqja Halvetije.

Nënkryetari, z. Besart Tofaj, pyeti nëse anëtarët kanë ndonjë temë për diskutim.

Tafë Gaxherri tha se ka mungesë të numrave të shtëpive në objektet e ndërtuara kohët e fundit dhe pyeti se kujt duhet t'i adresohet kjo çështje.

Nënkryetari Besart Tofaj tha se brenda Drejtorisë së Urbanizmit është zyrtari përgjegjës për të adresuar problemet, ankesat dhe kërkesat për adresa, si për emërtimin e rrugëve ashtu edhe për vendosjen e numrave.

Me kaq, nënkryetari Besart Tofaj e shpalli të mbyllur këtë mbledhje.

Procesmbajtësi,	Kryetari i Komunës, Kryesues i KKSB-së
_____	_____
Esat Hoxha	Ruzhdi Shehu